



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1985 .Prot.

Rrogozhinë, më 20.05.2025

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Hënë datë 26.05.2025 ora 14:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
 - 2- Miratim i procesverbalit Nr.4, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.04.2025.
 - 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
 - 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
 - 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
 - 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”.
 - 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratim Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “.
 - 8- Shqyrtim i informacionit, “Mbi punën e bërë nga sektori i MZSH-së për periudhën Maj 2024 - Prill 2025 dhe propozimet për përmirësimin e këtij shërbimi”, të ardhur nga Stacioni M.Z.SH-së Rrogozhinë.
 - 9- Shqyrtim i Informacionit mbi masat e marra për parandalimin dhe përballimin e situatës së zjarreve gjatë periudhës së verës të ardhur nga drejtoria e Bujqësisë.
 - 10- Shqyrtim i Raportit, “Mbi masat e marra për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përgatitjen e sezonit turistik në Bashkinë Rrogozhinë”, të ardhur nga drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
- (Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 28.04.2025).*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

11- Të ndryshme.

- Shqyrtim i ankesës nr.2, të ardhur nga z. H. Xhaferri.
- Të tjera.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Enjte datë 22.05.2025 ora 10 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani- Anëtare, Indrit Dedej -Anëtar.
- Njoftoj të mbledhet ditën e Enjte datë 22.05.2025 ora 10 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përberje : Lulzim Hasa - Kryetar, Isa Halili - Zëvendëskryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar

Shënim : Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI